



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE

Emërtimi i Modulit: Gjuhë Frënge për Mjekësinë Dentare

Lloji i Trajnimit: Trajnim i zhvilluar në formë hibride.

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: Frëngjisht

Kohëzgjatja e programit të modulit: 40 orë

Nr. i krediteve: 4 ECTS

Mënyra e zhvillimit: Nëpërmjet metodave aktive, pjesëmarrjes dhe aktiviteteve mësimore në formën e punës praktike.

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Ky modul është bazuar në katër shtyllat kryesore të fushës së stomatologjisë: autonomi, dobi, jo keqbërje dhe drejtësi. Në mënyrë të këtij moduli synojmë që të gjithë individët e interesuar të zhvillojnë aftësitë e tyre në komunikim me gojë dhe me shkrim në gjuhën frënge në fushën e mjekësisë dentare duke krijuar lehtësisht planet e trajtimit që të menaxhohen në mënyrë aktive nga sistemi për të siguruar një ndjekje të vlefshme për të gjeneruar prodhim, mbajtjen dhe futjen e shënimeve të detajuara të procedurës, të personalizuar nga përdoruesi me një klikim të vetëm në dosjen elektronike të pacientit, duke siguruar shërbim të shpejtë, të lexueshëm, në kohë reale dhe me pak përpjekje.

Një nga elementët kyç të këtij moduli është përmirësimi i komunikimit në gjuhën frënge, gjë që është thelbësore për stomatologët që operojnë në kontekste ndërkombëtare ose që punojnë me pacientë të huaj. Komunikimi efektiv, qoftë me gojë apo me shkrim, është jetik për krijimin e një marrëdhënieje të mirë me pacientët dhe për transmetimin e saktë të planeve të trajtimit.

Objektivat e modulit:

- përmirësimi i komunikimit në gjuhën frënge me klientët;
- përvetësimi i aspekteve gjuhësore;
- përvetësimi i terminologjisë së duhur për temat e trajtuara në fushën e mjekësisë dentare.

Rezultatet e të nxënit:

- përmirësimi i komunikimit në gjuhën Frënge me klientët;
- përvetësimi i aspekteve gjuhësore;
- përvetësimi i terminologjisë së duhur për temat e trajtuara në fushën e mjekësisë dentare;
- të shprehurit me shkrim dhe me gojë lidhur me temat e trajtuara.